



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN

# RAPORTIMI DHE FINANCIMI

# 2019









**RAPORTIMI I VIZITAVE TE KRYERA  
DHE  
PASQYRA FINANCIARE**

**RAPORTIMI I VIZITAVE TE MINISTRIT TE SHETIT PER DIASPOREN  
DHE  
PASQYRA FINANCIARE E UDHETIMEVE (Shkurt - Qershor 2019)**

**Itali, 14-17 Shkurt 2019**

**Romë, Itali**

- Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi një takim me përfaqësues të Konfederatës Kombëtare të Zejtarisë (KKZ). Gjatë këtij takimi, të dyja palët diskutuan mbi koordinimin dhe bashkëpunimin në fushën e sipërmarrjes dhe tregtisë, si një mjet i rëndësishëm për të nxitur investimet dhe për të forcuar marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Italisë.
- Shtypi italian pasqyroi vizitën e ministrit të Shtetit për Diasporën. AISE (Agjencia Ndërkombëtare e Shtypit të Huaj) ka shkruar për takimin e ministrit Majko me përfaqësuesin e seksionit të ekonomisë në Konfederatën Kombëtare të Zejtarisë (CNA), z. Claudio Giovine.
- Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në seminarin me temë “Diaspora shqiptare, pikënisje për formimin dhe zhvillimin e Evropës” i organizuar nga “Integra Onlus”, në Itali dhe fondacioni “Ura për të ardhmen”.

**Itali, 11-12 Mars 2019**

**Romë, Itali**

- Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në konferencën "Minoranca Arbëreshe, feja, kultura, tradita" që u zhvillua në senatin italian në Romë. Konferenca organizohet në kuadër të "100-vjetorit të institutit të Eparkisë së Lungros". Në fjalën e tij, ministri u ndal te historia e komunitetit arbëresh, si pjesë e pandarë e kombit dhe mbi të gjitha si pjesë thelbësore e historisë sonë.**SHBA, 8-13 Prill 2019**

**Boston, SHBA**

- Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në takimin e 11-të të konferencës ndërkombëtare për fuqizimin global “Global Empowerment Meeting” (GEM19), e cila organizohet çdo vit nga “Harvard Kennedy School” në SHBA.
- Ministri Majko u takua me personalitete të njohura të Diasporës shqiptare, si: anëtarin e Këshillit Koordinativ të Diasporës z. Gazmend Kapllani, mjekun Gani Abazi, zyrtaren e Administratës Lokale Arsimore znj. Zhaneta Liti, si dhe pjesëtarë të tjerë të komunitetit shqiptar në Boston.

## Washington D.C, SHBA

- Ministri i Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko u takua me zëvendës drejtorin e përgjithshëm të organizatës amerikane “Partneriteti për Qeveri të Hapur” (OGP), z. Joe Powell. Gjatë takimit me të u fol për një mundësi bashkëpunimi konkret midis qeverisë shqiptare, kësaj organizate dhe shoqërisë civile, bashkëpunim, i cili mund të çojë në hapjen e një zyre koordinimi të kësaj organizate në Shqipëri, si e vetmja pikë në rajon.
- Vizitë në Bibliotekën e Kongresit Amerikan, në të cilën ruhen vepra të autorëve shqiptarë, si Fan Noli dhe Faik Konica. Gjatë kësaj vizite, ministri Majko u takua me përgjegjës të seksionit evropian, z. Grant Harris, me të cilin u diskutua për mundësitë e bashkëpunimit dhe pasurimit të kësaj biblioteke me botime me fokus Diasporën shqiptare, të cilat do të jenë në dispozicion të komunitetit shqiptar.
- Takim me z. Patrizio Pagano, Drejtor Ekzekutiv i Bordit të Grupit të Bankës Botërore në Uashington DC, i cili përfaqëson Italinë, Shqipërinë, Greqinë dhe disa vende të tjera. Në këtë takim, ministri Majko diskutoi për mundësitë e thellimit të mbështetjes me projekte të Diasporës shqiptare, si një bashkëpunim midis ministrit të Shtetit për Diasporën dhe Zyrës së Bankës Botërore në Tiranë në kuadrin e Strategjisë së Bankës Botërore për vendin.
- Delegacioni i Ministrisë së Shtetit për Diasporën zhvilloi një takim me përfaqësuesit e Departamentit Amerikan të Shtetit për Punët e Jashtme, përfaqësues të Diplomacisë Elektronike, zyrën e Edukimit, këshilltarin për rininë globale si dhe zyrtarin e shtetit, përgjegjës për Shqipërinë. Në këtë takim, u diskutua për mënyrën e lehtësimit të pajisjes me viza të shqiptarëve si dhe për programet e shkëmbimit mes universiteteve shqiptare dhe atyre amerikane.

## Kosovë, 17-18 Prill 2019

### Prishtinë, Kosovë

- Ministri Majko mori pjesë në ceremoninë e 20-vjetorit të Eksodit të Luftës së Kosovës, ku në mënyrë simbolike priti sërish anëtarët e “Batalionit të Atlantikut”, ashtu si dy dekada më parë, por tashmë në një Kosovë të lirë dhe të pavarur.

## Ukrainë, 4-7 Maj 2019

### Karakut, Ukrainë

- Takim me pjesëtarët e komunitetit shqiptar në Karakut, Ukrainë në ditën e Shën Gjergjit, gjatë së cilës komuniteti nderon figurën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Ministri i Shtetit për Diasporën i dhuroi komunitetit abetare, libra për fëmijë në gjuhën shqipe dhe kostume tradicionale në shenjë falënderimi për ruajtjen e kulturës shqiptare dhe vazhdimësisë së saj.
- Ministri i Shtetit për Diasporën zhvilloi një vizitë në Ukrainë. Ai ishte i ftuar në një forum diskutimi në Universitetin Shtetëror në qytetin Izmail, ku foli për bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve. Të pranishëm në forum ishin jo vetëm studentë shqiptarë, por edhe studentë ukrainas, të cilët studiojnë kulturën dhe traditat shqiptare.
- Ministri i Shtetit për Diasporën dha një intervistë për mediat në Ukrainë ku foli për arsyen e vizitës së tij të dytë në Ukrainë, brenda një kohe të shkurtër. Ndër të tjera ai tha: “Synimi është për të rritur komunikimin, sidomos me shqiptarët e Ukrainës. Ekzistenca e shqiptarëve në Ukrainë për ne është një arsye më shumë për të pasur marrëdhënie të ngushta me vendin tuaj. Por, ne nuk duam të ngelemi vetëm te vizitat e zyrtarëve, jemi duke menduar disa projekte në fushën e arsimit dhe sidomos në fushën e biznesit”.

## Itali, 24-26 Maj 2019

### Romë, Itali

- Me rastin e 100-vjetorit të themelimit të Eparkisë së Ungros, delegacioni i Ministrisë së Shtetit për Diasporën, shoqëruar nga ambasadorja e Shqipërisë në Romë znj. Anila Bitri Lani dhe komuniteti shqiptar, mori pjesë në një audiencë të veçantë të mbajtur nga Papa Françesku, në Vatikan.

## Slloveni, 6-8 Qershor 2019

### Lubjanë, Slloveni

- Ministri i Shtetit për Diasporën mori pjesë në aktivitetin e organizuar me rastin e 30-vjetorit të shoqatës kulturore të shqiptarëve “Migjeni” në Lubjanë të Sllovenisë. Në këtë përvjetor të rëndësishëm ministri Majko i dorëzoi kësaj shoqate titullin “Naim Frashëri”, për “Veprimtarinë dhe angazhimin në mbrojtjen e çështjes kombëtare shqiptare”, titull ky akorduar nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë.

- Gjatë vizitës në Lubjanë, ministri Majko zhvilloi një takim me ministrin përgjegjës për Diasporën të Sllovenisë, z. Peter Jozef Cesnik me të cilin u bisedua për një marrëveshje bashkëpunimi dypalëshe me qëllim shkëmbimin e përvojave të dy vendeve.

**Shënim:**

*Të gjitha aktivitetet publike të kryera nën kujdesin apo pjesëmarrjen e Ministrit të Shtetit për Diasporën. Udhëtimet kryhen me miratimin e kryeministrit. Blerja e biletave për udhëtimet kryhet nga zyra e financës në administratën e kryeministrit!*



## PASQYRA FINANCIARE

Udhëtimet viti 2019	Ditët	Dieta	Hotel	Bileta	Të tjera	Tot Shuma Euro	Tot Shuma Dollar
<b>Romë, Itali 14-17 Shkurt</b>	<b>2</b>	<b>€ 160</b>	<b>€ 302</b>	<b>€ 367</b>	<b>€ 12</b>	<b>€ 841</b>	
<b>Romë, Itali 11-12 Mars</b>	<b>1</b>	<b>€ 80</b>		<b>€ 583</b>		<b>€ 663</b>	
<b>Boston, SHBA 8-13 Prill</b>	<b>5</b>	<b>\$ 400</b>	<b>\$ 2,033</b>	<b>€ 1,740</b>		<b>€ 1,740</b>	<b>\$ 2,433</b>
<b>Kosovë, Prishtinë 17-18 Prill</b>	<b>1</b>	<b>€ 80</b>	<b>€ 165</b>			<b>€ 245</b>	
<b>Ukrainë 4-7 Maj</b>	<b>3</b>	<b>€ 240</b>	<b>€ 170</b>	<b>€ 523</b>	<b>€ 44</b>	<b>€ 977</b>	
<b>Itali, Romë 24-26 Maj</b>	<b>2</b>	<b>€ 160</b>	<b>€ 349</b>	<b>€ 442</b>		<b>€ 951</b>	
<b>Ljubjanë, Slloveni 6-8 Qershor</b>	<b>2</b>	<b>€ 160</b>	<b>€ 451</b>			<b>€ 611</b>	
<b>TOTALI</b>		<b>\$ 400</b>	<b>2,033</b>				<b>2,433</b>
		<b>€ 880</b>	<b>1,437</b>	<b>4,449</b>	<b>56</b>	<b>6,822</b>	

FALEMINDERIT

